



Pranuar / Dorezuar Punimjeno/Protolatu Received/Delivered	01.06.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK 2760/2021			114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.376/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehemti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2860/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.859/2018 të datës 28.12.2018, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Lidhja e Prizrenit", në Lipjan, kundër Vendimit me numer KA-01/12-18 të datës 03.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.859/2018 e datës 28.12.2018 e parashtruar nga ankues

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA-01/12-18 i datës 03.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 28.12.2018, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8031/22018 të regjistruar me numër A.nr.859/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër KA-01/12-18 të datës 03.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2018, ka proceduar kerkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 21.01.2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje të ankesës, ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më Aktgjykimin A.nr.2860/2019 të datës 29.04.2021 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 28.12.2018 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.2860/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokollit 8031/2018 të datës 28.12.2018, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 05.11.2018 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Vendimin me numër KA-01/12-18 të datës 03.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.01.2019; Autorizimin për publikimin e konkursit datë 17.09.2018 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, Konkursin e datës 20.09.2018; Vendimin për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës (KPSHC) të datës 10.10.2018; Raportin final i rekomandimit nga KPSHC të datës 29.10.2018; Raportin e kandidatëve të përshtatshëm për emërim; Formularin Form. MAP-SHCK-11 të Raportit Final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 29.10.2018; Formularin Form.MAP-SHCK-10 për Rënditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhje e vlerësimeve individuale; Përmbledhjen e pikëve të përgjithshme dhe renditja e kandidatëve e datës 23.10.2018; Përmbledhjen e Vlerësimit nga testi me gojë e datës 23.10.2018; Rezultatet e testit me shkrim e datës 19.10.2018; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 11.10.2018; E-mailin e datës 29.10.2018; E-mail i datës 19.10.2018; Njoftimin e datës 11.10.2018, E-mailin e datës 12.10.2018, ftesën për test me shkrim; Listën e ngushtë të datës 04.10.2018; Regjistrin e Aplikacioneve të datës 04.10.2018; Formularët Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe; Testi me shkrim i datës 16.10.2018; Dosja e aplikimit të ankuesit-Diploma e Kolegjit AAB e datës 30.06.2018 "Bachelor në Administratë Publike", Vërtetimin e Datës 01.02.2016; Letër reference e datës 14.10.2018; Letër rekomandimit e datës 04.10.2018; Dosja e aplikimit -Diplomë Universitare e Fakultetit Filozofike në Prishtinë, të datës 29.10.2012 "Bachelor i Shkencave Politike", Diplomë Universitare e Fakultetit Filologjisë në Prishtinë të datës 24.12.2013, "Bachelor i Letërsisë Shqipe", Vërtetimi i datës 08.05.2017; Letër referencë e datës 08.05.2017; Letër referencë e të datës 25.09.2018; Dosja e aplikimit Diplomë e Kolegjit "ISPE" e datës 09.06.2016 të 'Bachelor i studimeve- Artet në Studime të Integruar Evropiane", Referencë e datës 03.10.2018; Letërrekomandim i datës 02.10.2018; Pasqyra e Trustit e datës 01.08.2002 - 01.10.2018; Dosja e aplikimit Diplomë Universitare e Fakultetit Filologjik në Prishtinë, për perfundim të studimeve me datë 15.02.2016 "Bachelor i gazetarisë", Referencë e datës 03.10.2018, Referencë e datës 24.06.2018; Kontratë e Punës së datës 07.01.2018; Pasyra e Trustit e datës 01.08.2002-05.10.2018; Dosja e aplikimit të Diplomë Universitare e Fakultetit Filozofike në Prishtinë, për perfusim të studimeve themelore me datë 14.10.2015 "Bachelor i Psikologjisë", Vërtetim i datës 27.06.2018, Letër referencë e datës 21.09.2018; Letër rekomandim i datës 21.09.2018; Referencë e datës 03.10.2018; Pasqyra e Trustit e datës 01.08.2002-01.10.2018; Kontratë për shërbime, e datës 07.01.2018.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka administruar provat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepe*:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të Autorizimit të datës 17.09.2018 të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike, me datë 20.09.2018 ka shpallur Konkursin DMMP-KRK-JK/236, për pozitën "Zyrtar i Programit për Edukim Qytetar", jo karrierës, me kohë të caktuar deri në dy (2) vite. Në këtë Konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili nuk është përfshirë në listën e ngushtë, për shkak së i njëjti nuk ka poseduar pervojë pune pas diplomimit.

Pas Njoftimit të datës 29.10.2018, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për kandidatët e suksesshëm për pozitën "Zyrtar i Programit për Edukim Qytetar", ankuesi me datë 05.11.2018, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili organ me Vendimin me numër KA-01/12-18 të datës 03.12.2018, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër KA-01/12-18 të datës 03.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor së Komisioni Përzgjedhës gabimisht nuk i ka njohur ankuesit pervojën 13 vjecare të punës para diplomimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për mos njohje të pervojës së punës para diplomimit, duke mos e përfshirë ankuesin në listë të ngushtë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke ju referuar Konkursit DMMP-KRK-JK/236, të datës 20.09.2018, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për pozitën "Zyrtar i Programit për Edukim Qytetar", kanë qenë: *Diplome fakulteti në lëmin e shkencave shoqërore; Përvojë pune profesionale në programe edukative për fëmijë/të rinj së paku dy (2) vjet.* Ndërsa duke iu referuar shkresave të lëndës, respektivisht Diplomës Nr.1145/18 të datës 13.07.2018, të lëshuar nga Bartësi Privat i Arsimit të Lartë, Kolegji "AAB", është konstatuar se ankuesi

me datë 30.06.2018 ka përfunduar studimet themelore në Programin Administratë Publike, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e pervojës së punës dy (2) vjecare pas diplomimit. Njohja e pervojës së punës vetëm pas diplomimit në fushën përkatëse është konfirmuar edhe me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë për pozitën "Zyrtar i Programit për Edukim Qytetar", ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 ku përcaktohet se: *1. Anëtarët e KPSHC- së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim; 1.1. Arsimi dhe Kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës;* Rrjedhimisht Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Kuvendit të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA-01/12-18 të datës 03.12.2018, përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, ka vërtetuar drjetë gjendjen faktike dhe bazën juridike dhe në këtë mënyrë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-

149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.376/2021

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

